

**NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Pergjithshem Dega në Novobërdë**, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me praktikantin Nusret Ramadani, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. G. nga Gj., për shkak të dy veprave penale, Sulm nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2351/2016, të datës 29.12.2016, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Ismet Ukshini, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me date 23.01.2017 ndersa me date 24.01.2017 publikisht shpalli , këtë,

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **E. G.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati H., dhe e ëma A., mbiemri i vajzërisë M., i lindur më ..... në Gj., me vendbanim në lagjen .....e- rruga ....., p.nr, ka të kryer shkollën e mesme- drejtimi Komunikacion,i pa martuar, i gjendjes së varfur ekonomike, Shqipëtar, Shtetas i Republikës së Kosovës, kinse i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet procedur tjetër penale ndaj tij ,në arrest shtëpiak nga data ..... deri me .....

**Është fajtor**

I.Sepse, më datë 25.12.2016, rreth orës 15:20 min, në parkingun e pompës së benzinës ,, F.P” në fshatin ., komuna e N., për shkak të një mosmarrëveshje rreth një borgji, i akuzuari E.G., me dashje ka përdorur forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që fillimishtë fjaloset me të dëmtuarin K. M., e më pas të njëjtin e sulmon me thikë, si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe gjatë kacafytjes i dëmtuari e rrëzon për toke të akuzuarin dhe ia merr thikën nga dora, në ato momente ndërhyjnë personat prezent dhe i ndajnë, kështu që i akuzuari me veprimet e tij, tek i dëmtuari ka shkaktuar dhimbje, mundim, frikë dhe shqetësim.

Me çka ka kryer veprën penale, **Sulm , nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se,**

II.Më datë ..... rreth orës 16:00 min, përballë Restorantit “V.” në fshatin P., për shkak të rastit të përshkruar si në dispozitivin nën I, i akuzuari E. G., me dashje ka përdorur forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që shkon afër puntorisë së të dëmtuarit të parë K. M. dhe në momentin që e sheh me veturë, vllaun e të dëmtuarit të parë, G. M. në shenjë hakmarrje, ai me veturën e tij ndalon dhe e bën një kthim në rrugë , dhe ia zë rrugën me veturën e tij dhe me at rast veturat ndeshen mes vete, ashtu që i akuzuari del nga vetura me një shufër druri si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor dhe e sulmon të dëmtuarin G. M., mirpo nderhyjnë personat prezent dhe e ndalojnë, kështu që i akuzuari me veprimet e tij, tek i dëmtuari ka shkaktuar dhimbje, mundim, frikë dhe shqetësim.

Me çka ka kryer veprën penale, **Sulm , nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se,**

- andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,51,64,73,74,75 dhe 76,80 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së,

### **I SHQIPTON**

I.Për veprën penale si në dispozitivin I . te këtij aktgjykimi me dënim me burgim në kohë zgjatje prej 3 (tre ) muajve.

II.Për veprën penale si në dispozitivin II. te ketij aktgjykimi me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

Andaj gjykata konform nenit 80 paragrafi 1 dhe 2 te KPRK-se te akuzuarin,

### **E GJYKON**

Me denim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 5(pese) muajve, në të cilin dënim ka për të ju llogaritur edhe koha e kaluar në Arrest Shtëpiak prej 25.12.2016 deri me 23.01.2017, e i cili dënim do të ZAVENDSOHET me dënim me gjobë,ne shume prej 1.500(njëmijepesqind) € e te cilin dënim i akuzuari do ta paguaj ne afat prej 90 ditesh nga dita kur ky aktgjykim te behet i formës se prerë.

Nese i akuzuari nuk dëshiron qe ta paguaj gjobën e shqiptuar atëherë dënimi me gjobe do ti zëvendësohet me dënim me burgim ,ne ate menyre qe per gjdo 20(njëzet)€, te dënimit me gjobe do ti caktohet nga 1(nje) dite burgim.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej 20(njëzet)€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit : K. M. dhe G. M. , për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### **Ecuria e procedurës. I.**

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën e ushtruar me shkrim , PP.II.nr.2351/2016 , të datës 29.12.2016, e ka akuzuar E. G., nga Gj., për shkak të dy veprave penale- Sulm nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Pas ngritjes së aktakuzës palet me dat. 29.12.2016, kanë arritur marrveshje për pranimin e fajsisë e cila është deponuar në gjykatë me dat. 13.01.2017 e lidhur mes Prokuroris Themelore në Gjilan,-Departamenti i përgjithshëm, në njërën anë, si dhe mbrojtëses të të akuzuarit Blerina Jakupi Ramadani Av. nga Gjilani, dhe te akuzuarit në anën tjetër. Sipas kësaj marrveshtje gjykatësi i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit E. G., për veprën te cekur nen dispozitivin I , ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve dhe për veprën penale të përshkruar si në dispozitivin në II, ti shqiptohet dënimi po ashtu me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve ,te cilat do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se ketije aktgjykimi. Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i shqiptuar me burg ti zëvendësohet me dënim me gjobe.

Prokurori i shtetit Ismat Ukshini, mbrojtjsja e të akuzuari Blerina Jakupi-Ramadani në shqyrtimin fillestar, nji zëri deklaruan :se me rastin e arritjes së marrveshtjes për pranimin e fajësie është bër nji lëshim ashtu që nuk është marrë parasysh dispozita e nenit 80 të KPRK-ës, me rastin e bashkimit të dënimeve, andaj i propozojm gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit gjyakta, ta evitoj këtë lëshim dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënimin unik konform neni 80 të KPRK-ës.

## **II. Vlersimi i marveshjes per pranimin e fajsisë**

Ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me 23.01.2017 gjyqtari pas dëgjimit te palëve dhe ate te Prokurorit te Shtetit ,mbrojtëses se te akuzuarit dhe te akuzuarit e ka pranuar marveshjen per pranimin e fajsisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar te gjitha kushtet ligjore per nje gje te till.Ne kete aspekt gjytari ka konstatuar se i akuzuari E. G. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajsisë ,se pranimi i fajsisë eshte bere vullnetarisht nga i akuzuari ,pas konsultimeve me mbrojtësen e tij ,se i akuzuari nuk ka qene i shtrënguar qe ta pranoj fajsin dhe se pranimi i fajsisë ka mbështetje ne faktet qe i përmban aktakuza dhe se nuk egziston asnjë rrethan e parapar me dispozitën e nenit 253 paragrafi 1 te KPPK-së.

## **III.Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj ,duke u bazuar ne te cekurat me lart gjyqtari ka vërtetuar kete gjendje faktike se i akuzuari E. G. ka kryer dy vepra penale **sulm nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-Së**, ne kohen dhe ,mënyrën dhe vendin e përshkruar si ne dispozitivat e ketije aktgjykimi.

## **IV.Elementet e veprës penale**

Gjyqtari pas dëgjimit te palëve lidhur me dënimin , gjykata e shpalli fajtor te akuzuarin E. G. pershkak te dy veprave penale sulm nga neni 187 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-se ngase ne veprimet e tija manifestohen te gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se per te njëjtat eshte fajtor dhe penalisht përgjegjës .

## **V.Rrethanat qe jane marrur per baze me rastin e shqiptimit te dënimit .**

Duke u nisur nga fakti se me marrveshtje për pranimin e fajësis palët janë marrur vesh që të akuzuarit për sejcilën vepër ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 3(tre) muaj, apo dënimi unik prej 6 (gjashtë) duke mosashtu që

Gjykata me rastin e shqiptimit te dënimit ka vlersuar se duhet te aprovohet rekomandimi i paraqitur ne marveshjen per pranimin e fajsis ndaj te akuzuarit Endrit Gagica dhe te njëjtit ti shqiptohet dënimi me burgim ne kohezgjatje prej

5(pese) muajve i cili dënim me pëlqimin e te akuzuarit i eshte zëvendësuar me gjobe me te holla ,ashtu qe per nje dite burgim i eshte llogaritur nga 20(njëzet)€.

Meqense se ne marrveshjen e përpiluar per pranimin e fajsis palët janë marrur vesh qe te akuzuarit per secilën vepër penale ti shqiptohet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej nga 3(tre) muajve ,ashtu qe eshte parapar se te akuzuarit per këto dy vepra ti shqiptohet dënimi unik ne kohëzgjatje per 6(gjashte) muajve duke mos u marr per baze neni 80 i KPRK-se sipas te cilit eshte parapar se nëse kryersi kryen nje apo me shume vepra penale per te cilat gjykohen me te njëjtës kohe ,gjkata se pari shpall dënimin per secilën nga këto vepra ,e pastaj per te gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik ne 1500(njëmijë e pesëqind) euro të cilin dënim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e potfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërten ky vendim do të revokohet.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata mori për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në lartësinë e dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-ës. Kështu si rrethanë lehtësuese mori faktin se ka arritur marrveshjen me Prokurorin e shtetit për pranimin e fajsisë, pra ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepëres penale dhe pasojen e shkaktuar nga kjo vepër penale, andaj gjykata konsideron se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin sikur edhe te personat tjerë do të ndikojnë pozitivisht në parandalimin që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale.

Gjykata konform nenit 463 paragraf të KPRK-së të dëmtuarin, për realizimin e kërkesës pasuror-juridik ,udhëzohet në kontest civil.

Aktvendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata ka bazuar në dispozitën e nenit 453 paragraf 1, e në lidhje me nenin 450 paragraf 1 nën paragraf 2 .6 të KPRK-së.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike është i bazuar në dispozitën e nenit 463 par.1 të KPRK-ës.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivë të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË NOVOBËDË –**

Departamenti Përgjithshëm

**P.nr.03/2017, më 23.01.2017.**

Proqesmbajtsja  
Fjolla Huruglica

Gj y q t a r i  
Hasan Sadiku

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.